



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 187

Tiranë – E hënë, 10 tetor 2016

PËRMBAJTJA

Faqe

Udhëzim i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave nr. 4095, datë 10.10.2016

Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.....

20941



UDHËZIM

Nr. 4095, datë 10.10.2016

PËR MËNYRËN E DEKLARIMIT TË PASURIVE, NË PRONËSI, POSEDIM DHE PËRDORIM, BURIMET E KRIJIMIT TË TYRE, DETYRIMET FINANCIARE ETJ., NGA SUBJEKTET E RIVLERËSIMIT DHE PERSONAT E LIDHUR QË MBARTIN DETYRIM PËR DEKLARIM TË PASURISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 84/2016, DATË 30.8.2016, “PËR RIVLERËSIMIN KALIMTAR TË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit D, të ligjit nr. 76/2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neneve 30, 31, 32, 33, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, inspektori i përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), me qëllim përcaktimin e rregullave për mënyrën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, si dhe dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimit dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive,

UDHËZON:

1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklaram, pjesë përbërëse e këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, duhet të dorëzojnë deklaratën e pasurisë në ILDKPKI, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Data e dorëzimit, e shënuar në faqen 1 të deklaratës së pasurisë, duhet të përputhet me gjendjen e të dhënave të deklaruara në faqet e tjera të deklaratës së pasurisë.

- Dorëzimi i deklaratës së pasurisë duhet të bëhet nga vetë subjekti, në protokollin e

ILDKPKI-së, ku do të pajiset me vërtetimin përkatës për dorëzimin e deklaratës dhe fletën e inventarit për dokumentacionin justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë.

3. Deklarata duhet të shoqërohet me certifikatën personale dhe certifikatën familjare të subjektit të rivlerësimit, e cila duhet të jetë lëshuar brenda 3 muajve të fundit.

Bashkëlidhur, subjekti i rivlerësimit duhet të dorëzojë fotokopje të letrës së njoftimit (kartës së identitetit) për vete, bashkëshortin/en, bashkëjetuesin/en, fëmijët në moshë madhore dhe çdo person, sipas certifikatës familjare.

Në mungesë të letrës së njoftimit, të dorëzohet fotokopje e pasaportës ose certifikata personale e subjektit dhe e personave të lidhur.

- Deklarata e pasurisë nuk do të pranohet dhe do të konsiderohet e padorëzuar nëse nuk shoqërohet me dokumentacionin e identifikimit të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

4. Persona të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person i përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, për subjektin e rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit.

Kur pasuria e personave të lidhur (bashkëshorti/ja, fëmijët në moshë madhore, persona të tjerë sipas certifikatës familjare dhe bashkëjetuesi/ja) është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas dhe i bashkëlidhet deklaratës së subjektit të rivlerësimit.

5. Kur subjekti i rivlerësimit në rrethin e personave të lidhur me të, ka subjekte deklaruese për shkak të funksionit në ILDKPKI, por që nuk janë subjekte të procesit të rivlerësimit, personat e lidhur mbartin detyrimin të deklarojnë të dhënat e detyrueshme për deklaram, pjesë përbërëse të këtij procesi deklarimi, me përshkrimet e kërkuara sipas shtojcës 2, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur deklarates së pasurisë të subjektit të rivlerësimit.



6. Persona të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë personat fizikë dhe juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

Kur subjekti i rivlerësimit deklaron këto lloj marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, që bëhet objekt i kësaj marrëdhënieje me subjektin e rivlerësimit.

7. Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre.

8. Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të regjistruara ose jo në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratë shitblerje, kontratë sipërmarrje, akt marrëveshje, kontratë paraprake, kontratë porosie etj., dhe certifikatën e pronësisë në rastet kur prona është e regjistruar në ZVRPP.

9. Deklarimi i pasurive të paluajtshme në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t, të shoqërohet me kopje të të gjithë dokumentacionit të paraqitur pranë këtij institucioni.

10. Deklarimi i pasurive të paluajtshme të dhëna me qira te persona të tjerë të lidhur, të shoqërohet me kontratën e qiradhënies të lidhur para noterit.

11. Deklarimi i pasurive të paluajtshme të marra me qira te persona të tjerë të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këtë veprim juridik, si dhe dokumentacionin e pronësisë të personit tjetër të lidhur (pronarit) për objektin e dhënë me qira.

12. Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve dhe çdo pasurie tjetër të fituar nëpërmjet dhurimit, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këtë veprim juridik, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (dhuruesit).

13. Deklarimi i pasurive të luajtshme, të regjistruara në regjistrat publikë, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, kontratën e shitblerjes dhe vërtetimin përkatës nga institucioni i zhdoganimit dhe i regjistrimit të kësaj pasurie.

14. Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditeteve etj., në posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për këto marrëdhënie juridike, si dhe dokumentacionin justifikues të pronësisë të personit tjetër të lidhur (pronarit).

15. Deklarimi i huamarrjeve dhe huadhëniesh në likuiditete, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor dhe me vërtetimet bankare, në rast se veprimi në kohën e kryerjes së tij është kryer me transaksion bankar.

16. Deklarimi i pasurive të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete etj., të fituara nga trashëgimia, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor, që identifikon si pronar të pasurisë trashëgimore të deklaruar personin tjetër të lidhur, trashëgimlënësin.

17. Deklarimi i gjendjes “*cash*” do të njihet si i tillë në konceptin e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, deri në kufirin e shumës 1.5 milionë lekë. Shumat më të mëdha duhet të formalizohen në sistemin bankar, përpara dorëzimit të deklaratës në ILDKPKI, duke bashkëlidhur në çdo rast vërtetimin bankar për këtë veprim.

18. Nëse subjekti i rivlerësimit deklaron marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohet të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit, të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë subjektit të rivlerësimit.

19. Nëse personat e lidhur me subjektin e rivlerësimit deklarojnë një marrëdhënie me persona të tjerë të lidhur (fizikë dhe juridikë) në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit, detyrohen të paraqesin dokumentacionin justifikues ligjor të lëshuar nga institucionet shtetërore dhe private për personat e tjerë të lidhur, referuar burimit të krijimit të dhurimit, huadhënies dhe huamarrjes, dhënë personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.



20. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga pagat, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor për të ardhurat neto nga institucioni pranë të cilit kanë qenë dhe janë të punësuar subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë.

21. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga emigracioni prej subjektit dhe/ose personave të lidhur, të shoqërohet me dokumentacionin justifikues ligjor nga vendi i punës, qyteti dhe shteti përkatës, për periudhën e deklarimit, si dhe mënyrën e kalimit të këtyre mjeteve monetare brenda territorit të Shqipërisë.

22. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga aktiviteti privat i subjektit të rivlerësimit dhe/ose personave të lidhur me të, të shoqërohet për periudhën e deklaruar me dokumentacionin justifikues ligjor nga zyrat e tatim taksave për fitimin e realizuar dhe dividendin e tërhequr.

23. Deklarimi si burim krijimi pasurie i të ardhurave nga qiraja, të shoqërohet me vërtetimin përkatës për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiraja.

24. Deklarimi i kredive të marra nga bankat/institucionet financiare, duhet të shoqërohet me kontratën e lidhur me bankën/institucionin financiar, kolateralin e vënë si garanci, si dhe një vërtetim nga banka/institucioni financiar për gjendjen e kredisë në datën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë.

25. Nëse subjekti i rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë pasuri jashtë territorit të

Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqesin deklaratimet bankare të viteve të fundit, të dhënat e fundit mbi regjistrimin e pasurisë, si dhe dokumente të tjera që tregojnë vlerën e pasurive që ndodhen jashtë vendit.

26. Për rastet kur subjektet e rivlerësimit dhe/ose personat e lidhur me të, kanë kryer ndërtime, shtesa ose rikonstruksione të pjesshme ose të plota, për banesa ose çdo ndërtim tjetër, duhet të paraqesin dokumentacionin e plotë ligjor, lejen e ndërtimit, preventivin, situacionin e plotë të shpenzimeve të kryera etj.

27. Subjekti i rivlerësimit, si dhe personat e lidhur me të, mund të dorëzojnë edhe çdo dokument tjetër justifikues në mbështetje të deklaratës së pasurisë.

- Dokumentacioni justifikues i dorëzuar më parë në ILDKPKI, nuk e shkarkon subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të nga përgjegjësia dhe detyrimi për dorëzimin e të gjithë dokumentacionit justifikues në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

28. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur, të përcaktuar në nenin 3, të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Ganaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 28 lekë